

**Plani i Komunikimit Për Ditën e Zgjedhjeve  
Zgjedhjet Vendore Shqiptare, 21 Qershor, 2015**

**21 Qershor, 2015**

**Hotel Rogner, Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Tiranë**

<b>10:00</b>	<b>Konferenca e Parë e Shtypit për Ditën e Zgjedhjeve</b>  Procedurat e hapjes të qendrave të votimit
<b>17:00</b>	<b>Konferenca e Dytë Shtypit për Ditën e Zgjedhjeve</b>  Zhvillimet në lidhje me procedurat e votimit gjatë gjysmës së parë të ditës së zgjedhjeve

**SHËNIM:**

*Në rast të shkeljeve të rënda gjatë ditës së zgjedhjeve dhe/ose pas mbylljes së qendrave të votimit, Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme dhe Demokraci te Qendrueshme (KZLNDQ) mund të vendosë për të organizuar një konferencë emergjente për shtyp dhe/ose të lëshojë deklarata emergjente me qëllim për të njoftuar menjëherë publikun në lidhje me zhvillimet e reja.*

**22 Qershor, 2015**

**Hotel Rogner, Bulevardi “Dëshmoret e Kombit”, Tiranë**

<b>09:30</b>	<b>Konferenca e Parë e Shtypit për Ditën Pas Zgjedhjeve</b>  Raporti i Përkohshëm që paraqet gjetjet e vëzhgimit për të gjithë ditën e zgjedhjeve.
--------------	--

Përmbajtja e paraqitur do të publikohet menjëherë në:

- KZLNDQ website: [www.kzln.org.al](http://www.kzln.org.al);
- KZLNDQ Faqja e Facebook: Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme;
- KZLNDQ llogaria e Twitter: *KZLN\_CFFE\_Albania*

Në ditën e Zgjedhjeve të 21 Qershorit, KZLN do të vendosë 1000 vëzhgues të palëvizshëm në 1000 qendra votimi. KZLNDQ do të jetë e pranishme në qendrat e votimit që nga fillimi i



procedurave të hapjes deri në fund të procedurave të mbylljes. Qendrat e përzgjedhura të votimit përfaqësojnë një kampion të përfaqësuar statistikisht në nivelin e Shqipërisë, si dhe të Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit.

Përveç kësaj, KZLNDQ do të mbulojë të gjithë komunën e Himarës. Informacionet nga vëzhguesit do të mblidhen nëpërmjet qendrës të telefonatave (call center) të bazuar në Tiranë dhe nëpërmjet përpjekjeve të 35 operatorëve. Të dhënat do të mblidhen me anë të SMS-ve dhe thirrjeve telefonike që do të hidhen në një bazë të dhënash të ndërtuar posaçërisht për këtë projekt. Të gjithë vëzhguesit e KZLNDQ kanë përfunduar tre nivelet e testimit.

KZLNDQ do të vazhdojë procesin e monitorimit të numërimit në qendrat e numërimit të votave dhe, në varësi të cilësisë së procesit, do të vendosë nëse do të informojë publikun në lidhje me konstatimet e saj vetëm në raportin e saj përfundimtar, ose më herët në këtë proces.

Përpjekjet e vëzhgimit të KZLNDQ mbështeten nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) përmjet Assist Impact, dhe me asistencën teknike nga Instituti Demokratik Kombëtar (IDK).

###

*Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme e Demokraci të Qendrueshme (KZLNDQ) është një koalicion i pavarur, jopartiak, i krijuar me qëllim nxitjen e pjesmarrjes së qytetarëve në votime dhe vëzhgimin e proceseve zgjedhore. KZLNDQ, bazuar në të dhënat e datës 6 qershor 2015, përbëhet nga 30 organizata partnere dhe nga qindra vullnetarë në të gjithë Shqipërinë.*

*Projekti i KZLNDQ-së për vëzhgimin e zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 21 Qershor 2015 mbështetet nga Assist Impact nëpërmjet fondeve të USAID-it. Në procesin e vëzhgimit të Zgjedhjeve Lokale në Shqipëri 2015, KZLNDQ po asistohet teknikisht nga Instituti Demokratik Amerikan, NDI.*

*Për më shumë informacion, ju lutemi të shihni portalin online [www.kzln.org.al](http://www.kzln.org.al) ose të kontaktoni:*

*Mirela Arqimandriti, drejtuese e skuadrës së vëzhgimit të zgjedhjeve.*

*Erjona Mulellari, drejtore ekzekutive.*

*Dhimitër Gjodede, koordinator i vëzhguesve afatgjatë*

*Email: [kzln@kzln.org.al](mailto:kzln@kzln.org.al) Cel: 00355 68 20 59 301 ; 0684046770*

*Facebook: Koalicioni për Zgjedhje të Lira e të Ndershme*

*Twitter: KZLN\_CFFE\_Albania*

